



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURENCËS-**  
**KOMISIONI I KONKURENCËS**

---

**Njoftim për shtyp**  
(Tiranë, më 01.10.2007)

**Për ndalimin e Marrëveshjes në Tregun e Prodhimit të Bukës në Qarkun e Fierit**

Në mbledhjen e datës 01 tetor 2007, Komisioni i Konkurrencës mori në shqyrtim Raportin e Grupit të Punës për përfundimin e procedurës së Hetimit Paraprak dhe rezultatet e inspektimeve të kryera, prej nga konstatoi se ndërmarrjet nën hetim, “Marlen” sh.p.k , “Basha” sh.p.k, “Apollonia B” shpk, “Fatri Zijaj”, “Vladimir Resuli”, “Lavdiqe Ramaj” (Patos), “Genci Numanaj”(Patos), “Sokol Malaj” (Ballsh), “Ylber Shameti” (Ballsh), “Valter Veizi” (Ballsh), me datë 08 gusht 2007, kanë nënshkruar një marrëveshje që bie në kundërshtim me nenin 4, pika 1, germa a), e Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, sepse :

- 1) fikson çmimet e shitjes së bukës masive në 100 Lekë dhe
- 2) rrit çmimet e llojeve të tjera të bukës me rreth 17%.

Marrëveshja, që ka hyrë në fuqi që me datë 16.08.2007, përbën shkelje të rëndë të konkurrencës pasi grupimi i ndërmarrjeve eliminon konkurrencën mes tyre duke fiksuar çmimin e shitjes, bie ndesh me nenin 4/a të ligjit nr. 9121 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” dhe përbën shkelje të rëndë (kartel).

Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja d, nenin 45 të ligjit Nr.9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” dhe nenit 61 të Kodit të Procedurave Administrative, vendosi ndalimin e Marrëveshjes së lidhur më datë 08.08.2007 ndërmjet ndërmarrjeve prodhuese të bukës në Qarkun e Fierit.

Sipas nenit 74, pika 1, germa a të ligjit nr. 9121 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” ndërmarrjet pjesëmarrëse në këtë marrëveshje mund të gjobiten nga 2-10 për qind të xhiros vjetore të vitit paraardhës.

Komisioni ka ngarkuar Sekretariatin për vazhdimin e hetimit për të përcaktuar pasojat e veprimt antikorrues dhe njoftimin e palëve të përfshira në këtë hetim, si dhe organizimin e seancave dëgjimore. Afati i mbylljes së procedurave dhe marrja e vendimit nga ana e Komisionit të Konkurrencës do të jetë brenda 45 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.